U R D H Ë R
Datë 27.4.1999

PËR DOKUMENTACIONIN QË DUHET TË MBAJNË SHOQËRITË E TREGTIMIT ME SHUMICË DHE STACIONET E SHITJES SË KARBURANTEVE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të neneve 14 e 15 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin e tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre",

U R D H Ë R O J M Ë:

1. Shoqëritë e tregtimit me shumicë të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre janë të detyruara të mbajnë pranë impianteve apo instalimeve ku ushtrojnë veprimtarinë dokumentet e mëposhtme:

a) Lejen e dhënë nga Ministria për ushtrimin e veprimtarisë.

b) Certifikatën e regjistrimit në Zyrën e Tatimeve dhe dokumentin e NIPT.

c) Librat e blerjeve e të shitjeve, sipas modeleve të miratuara nga organet tatimore, të plotësura me lëvizjet e çdo dite.

ç) Kopje të kontratave të lidhura për blerjet, importet apo shitjet.

d) Kopje të faturave për blerjet dhe shitjet, të plotësura këto sipas ligjit "Për tatimin mbi vletrën e shtuar".

dh) Dokumentet e pagesave të bëra sipas pikës 6 të nenit 14 të ligjit nr.8450, datë 25.2.1999 "Për përpunimin, transportimin e tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre".

e) Kopje të urdhrit për sasinë e rezervës së sigurisë gjatë vitit në vazhdim.

ë) Dokumentacionin për standardin dhe markën e produkteve e të nënprodukteve të tregtuara.

Këto subjekte janë të detyruara, që pranë selive të tyre, të mbajnë edhe një kopje të dokumentacionit të paraqitur e të pranuar për marrjen e lejes së tregtimit.

2. Stacionet e shitjes së karburanteve janë të detyruara të mbajnë pranë impianteve apo instalimeve, ku ushtrojnë veprimtarinë, dokumentet e mëposhtme:

a) Certifikatën e regjistrimit në Zyrën e Tatimeve dhe dokumentin e NIPT.

b) Autorizimin e dhënë nga organi i qeverisjes vendore apo Ministria për ushtrimin e veprimtarisë.

c) Librin e hyrje-daljeve të plotësuar rregullisht për çdo ditë, sipas formularit bashkëlidhur.

ç) Dokumentet e blerjes së kontigjenteve, kontratën, dokumentin e pagesës.

d) Dokumentacionin për standardet dhe markën e nënprodukteve që tregtojnë.

dh) Stacionet e shitjes së karburanteve janë të detyruara që në secilën pompë të kenë aparate matëse të cilat kanë memorje fiskale, automatike, të cilat të jenë nën kontrollin e Institutit të Meterologjisë dhe Kalibrimit.

e) Stacionet e shitjes së karburanteve duhet të kenë të instaluar edhe arkën regjistruese, sipas ligjit nr.7758, datë 12.10.1993 "Për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për tatimet".

Këto subjekte janë të detyruara, që në selitë e shoqërive të tyre, të mbajnë edhe një kopje të dokumentacionit të paraqitur e të pranuar për marrjen e autorizimit për ushtrimin e veprimtarisë.

3. Subjektet e mësipërme janë të detyruara të mbajnë dhe çdo dokument tjetër të kërkuar nga dispozitat ligjore në fuqi.

4.Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

M I N I S T R I M I N I S T R I
Ylli Bufi Anastas Angjeli

Nr.1762 Prot.
Datë 27.4.1999